

Shëndetësia dhe asistenca sociale

Tekste prezantimi në ppt

Slide 1 SHËNDETËSIA NË ITALI

Slide 2 ASISTENCA SHËNDETËSORE

Për të pasur të drejtë për asistencë shëndetësore është e nevojshme të regjistroheni pranë Shërbimit Shëndetësor Kombëtar

Ku?

Pranë ASL-it, agjencisë shëndetësore lokale

Kujdes

ASL-i ku bëni pjesë tregohet në lejen tuaj të qëndrimit

Slide 3 REGJISTRIMI PRANË ASL-it

Për t'u regjistruar pranë ASL-it dhe për të marrë kartën shëndetësore, nevojitet të merret me vete:

- dokumenti i identitetit
- kodi fiskal
- leja e qëndrimit
- vetë-dokumentimi i banesës ose shtëpisë

Kujdes

Nevojitet të shkoni pranë ASL-it për të zgjedhur mjekun e familjes dhe pediatrin për fëmijët

Slide 4 KARTA SHËNDETËSORE

Karta shëndetësore është rajonale

Kujdes

Në rast se transferoheni në Rajon tjetër, njoftoni ASL-in e vendit të banimit
Nëse është njoftuar ASL-i, mund të vazhdoni të shfrytëzoni të gjitha shërbimet shëndetësore (mjekun, pediatrin, medikamentet, spitalin, etj.)

Slide 5

ME KARTËN SHËNDETËSORE

Shtetasi ka të drejtën për:

- vizita në ambulancë
- vizita të specializuara
- vizita në shtëpi
- shtrim në spital
- vaksinime
- analiza gjaku
- radiografi, ekografi
- medikamente
- rehabilitim

Kujdes

Për disa vizita dhe medikamente nevojitet të paguhet “ticket”

Slide 6

KËSHILLA TË DOBISHME PËR SHËNDETIN E FËMIJËVE

Janë të detyrueshme vaksinimet kundër:

- difterisë
- tetanosit
- poliomielitit
- hepatitit B

Për informacione të tjera

- pyesni mjekun e familjes
- shkoni pranë ASL-it

Slide 7

URGJENCA

Në rast sëmundjeje të rëndë ose aksidenti:

- shkoni në spital tek Urgjenca
- ose telefononi numrin 118 për të thirrur ambulancën

Kujdes

Në urgjencë koha e pritjes varet nga serioziteti i gjendjes

Slide 8

PRITJA NË URGJENCË

Kodi i kuq

Gjendja shëndetësore shumë e rëndë: ka përparësi për vizitën mjekësore

Kodi i verdhë

Gjendja shëndetësore e rëndë: pritje e shkurtër për vizitën mjekësore

Kodi i gjelbër

Gjendja shëndetësore pak e rëndë: pritje e gjatë dhe vizitë pas të sëmurëve në gjendje më të rëndë,

Kodi i bardhë

Gjendja NUK është shqetësuese: pritje shumë e gjatë dhe vizitë pas të gjithë të sëmurëve të tjerë, Në disa raste paguhet "ticket"

Slide 9

SËMUNDJET E LEHTA

- dhimbje koke
- dhimbje dhëmbi
- dhimbje barku
- dhimbje stomaku
- kollë, ftohje ...

Për sëmundjet e lehta

- shkoni në farmaci
- kërkoni këshillë nga farmacisti
- blini medikamentet

Kujdes

Farmacisti mund të japë vetëm ndonjë këshillë, sepse është mjeku i familjes që kuron sëmundjet

Slide 10

ASISTENCA SOCIALE NË ITALI

Slide 11

EKZISTOJNË SHUMË SHËRBIME SOCIALE PËR...

- të miturit (fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç)
- të moshuarit
- personat me aftësi të kufizuar
- të varfrit
- ...

Kujdes
Shërbimet sociale ndryshojnë nga qyteti në qytet

Slide 12 INFORMACIONE MBI SHËRBIMET SOCIALE

Për informacione mbi shërbimet sociale të qytetit ku banoni
- pyesni në Komunë

Slide 13 DOKUMENTET PËR ASISTENCËN SOCIALE ...

Shtetasit e huaj kanë të njëjtat të drejta si italianët
POR për të përfituar asistencë sociale

shpesh duhet të paraqesin:

- vërtetimin e banimit
- lejen e KE-së për ata që kanë leje qëndrimi afatgjatë

Slide 14 VARFËRIA DHE ASISTENCA SOCIALE

I sëmurit që ka mjete të pakta ekonomike mund të përfitojë ndihmën e asistencës sociale nëse është:

- i verbër ose invalid civil
- grua e pamartuar shtatzënë ose me fëmijë të vegjël

Edhe familjet në vështirësi mund të marrin ndihma.

Shembuj

- për qiranë
- për mensën shkollore të fëmijëve
- ...

Slide 15 FJALORTH

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar: sistemi publik i asistencës shëndetësore për të gjithë shtetasit

ASL: agjencia shëndetësore lokale që bën pjesë në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar

Vaksinë: injektim që mbron nga disa sëmundje

